



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

NR. 33 , DATË 31 / 03 /2021

PËR

MIRATIMIN E FONDIT TOTAL PREJ 39'857'100 LEKË PËR RIKONSTRUKSIONIN E RRUGËS "AZEM HAJDARI", FSHATI XHAFZOTAJ, NJËSIA ADMINISTRATIVE RRASHBULL, RINDËRTIMIN E KALIMEVE (TOMBINO) TË PRISHURA NGA PËRMBYTJET, NË NJËSINË ADMINISTRATIVE KATUNDI I RI, RINDËRTIMIN E KALIMEVE QË DO TË PRISHEN NË KANALIN E UJRAVE TË LARTA DHE NDRIÇIMI I RRUGËS "KRISTO SOTIRI", NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR 4. BASHKIA DURRËS

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, ligjit nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligjit nr. 137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të Buxhetit", VKB-së nr.123, datë 24.12.2020 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2021 si dhe projektbuxhetin afatmesëm të Bashkisë Durrës për vitet 2021-2023", si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimeve dhe Drejtoria e Buxhetit, zëvendëskryetari i Bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak Durrës,

KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI


1. Miratimin e fondit prej 14'294'500 lekë për objektin Rikonstruksion i Rrugës "Azem Hajdari - Migjeni", Fshati Xhafzotaj, në Njësine Administrative Rrashbull, Durrës.
2. Miratimin e fondit prej 8'275'600 lekë për objektin Rindërtimi i Kalimeve (tombino) të prishura nga përmytjet, në Njësine Administrative Katundi i Ri, Durrës.
3. Miratimin e fondit prej 8'272'000 lekë për objektin Rindërtimi i Kalimeve që do të prishen në kanalin e ujrave të larta, në Njësine Administrative 4, Durrës.

4. Miratimin e fondit prej 9'015'000 lekë për objektin ndriçimi i Rrugës "Kristo Sotiri", në Njësinë Administrative 4, Durrës.
5. Fondi prej 31,581,500 lekë do të merret nga fondi rezervë i bashkisë Durrës për vitin 2021, miratuar me VKB-në nr. 123, datë 24.12.2020 "Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2021 si dhe projektbuxhetin afatmesëm të Bashkisë Durrës për vitet 2021-2023" dhe VKB nr 21 datë 25.02.2021 Për miratimin e përdorimit të fondit të trashëguar nga viti 2020, të cilat i shtohen buxhetit të vitit 2021 të bashkisë Durrës.
6. Fondi prej 8,275,600 lekë do të merret nga fondi i emergjencave civile të bashkisë Durrës për vitin 2021, miratuar me VKB-në nr. 123, datë 24.12.2020 "Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2021 si dhe projektbuxhetin afatmesëm të Bashkisë Durrës për vitet 2021-2023" dhe VKB nr 21 datë 25.02.2021 Për miratimin e përdorimit të fondit të trashëguar nga viti 2020, të cilat i shtohen buxhetit të vitit 2021 të bashkisë Durrës.
7. Ngarkohen Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria e Shërbimeve dhe Sektori i Prokurimeve, Bashkia Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës.

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



SEKRETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

*Alpeporosi dhe me mundësi,
Almeida Rashi*



U shpall sot më datë 01.04.2021

BASHKIA DURRES
D/L: 07/4/21 Nr. 3753/3
PROT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 247/prot.

Durrës, më 07.04.2021

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK

DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr. 33 datë 31.03.2021 Për miratimin e fondit total prej 39'857'100 lekë për rikonstruksionin e rrugës "Azem Hajdari", fshati Xhafzotaj, Njësia Administrative Rrashbull, rindërtimin e kalimeve (tombino) të prishura nga përmytjet në Njësinë Administrative Katund i Ri, rindërtimin e kalimeve që do të prishen në kanalën e ujrave të larta dhe ndriçimi i rrugës "Kristo Sotiri" në Njësinë Administrative Nr. 4, Bashkia Durrës.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI
ROLAND NASTO